



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 73 prot.

Kamëz, më 18.04.2023

V E N D I M

Nr. 59.Datë 18/042023

MBI

“NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËVE NË TERRITORIN E BASHKISË
KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz, i mbledhur sot me datë 18.04.2023, pasi mori në shqyrtim kërkesën për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Perjetesia” në “Mark Martin Perpalaj” datë 18.04.2023, dhe ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Shtiçen” në “Rashit Beqa” datë 16.04.2023, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nënpika 1.7, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ll” dhe nenit 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 3, të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar; **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

- Emërtimin “Mark Martin Perpalaj” rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Emërtimin “Rashit Beqa” rrugës sipas fragmentit të hartës, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Çdo vendim i mëparshëm që bie në kundërshtim me pikën 1, të këtij vendimi, shfuqizohet.
- Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

